



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria e Inspektorateve - Inspektorati Sanitar

Nr. 17-53-zyrtarisht

Dt. 18. 4.2014

P r i z r e n

Nga: Inspektorati Sanitar

Për: OJQ“Ec Ma ndryshe“

Lënda: Përgjigje rreth çështjes së pirjes të duhanit


Inspektorati Sanitar sipas kërkesës nr. 001-029-40703 i datës 15.4.2014 te OJQ“EC MA NDRYSHE“ ne baze te kompetencave lëndore jep këtë përgjigje për pyetjen e parashtruara:


Me qellim te mbrojtjes se shëndetit publik nga pasojat shkatërruese shëndetësore, sociale, ekonomike dhe mjedisore te konsumimit te duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit te duhanit, bazuar ne Ligjin për Kontrollin e Duhanit 04/L-156, Inspektorati Sanitar i Komunës se Prizrenit ka punuar ne mënyrë permanente ne zbatimin e këtij ligji.

Inspektorati sanitar u ka leshu pothuajse te gjitha objekteve hoteliere,objekteve arsimore,parashkolllore,shëndetësore,publike Aktvendimet me te cilat u ndalohet rreptësisht konsumimi i duhanit brenda hapësirave te objekteve ne fjale,dhe ka punuar dhe punon në vazhdimësi për zbatimin e kësaj ndalese. Për objektet te cilat nuk e kane zbatuar urdhëresën Inspektorati Sanitar ka iniciuar me dhjetëra fletëparaqitje ne gjykatën themelore –divizioni për kundërvajtje kundër subjekteve afariste ku është konstatuar se edhe me tej konsumohet duhani.

Mund te themi se zbatimi i ligjit për duhanin ne Komunën e Prizrenit gjate gjithë ditës është i kënaqshëm edhe pse gjendja nuk është ideale ne përpikëri por sa i përket lokaleve gjate orëve te natës nuk jemi te kënaqur ne këtë drejtim. Për këtë arsye jemi ka planifikojmë qe gjate javëve te ardhshme Inspektorati Sanitar do te organizoje aksione me qellim qe ky ligj të gjejë zbatueshmëri dhe te krijoj efekte pozitiv ne ndalimin e pirjes se duhanit .

Koordinatori ,


Faredin Ajdini



Drejtori
Msc. Bedri Bytyqi